



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryezë Diskutimi: Informimi dhe Ndërgjegjësimi mbi Fintech – Risitë dhe Rreziqet në kuadër të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

30 tetor 2025, ora 09:30 – 11:30
Gold Orchid, Xheko Imperial Hotel, Tiranë

Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takim e radhës të Grupit të Punës për Kapitullin 24, në kuadër të **Konventës Kombëtare për Integrimin Europian**. Tryeza për Kapitullin 24 përbën një hapësirë me rëndësi duke mundësuar përfshirjen e aktorëve jo-shtetërorë, si shoqëria civile, sektori privat financiar, dhomat e tregtisë apo akademisë në procesin e negociatave. Qëllimi i saj nuk është vetëm informimi mbi procesin, por përfshirja aktive e tyre në dhënien e rekomandimeve dhe komenteve mbi kuadrin ligjor dhe politikat e miratuara, si dhe në monitorimin e të gjithë procesit në fazat e tij të ndryshme.

Ky aktivitet synon të informojë aktorët e komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit mbi risitë dhe rreziqet që sjell Fintech në kontekstin e luftës kundër pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Takimi, informues dhe konsultues njëkohësisht, shqyrton në mënyrë të thelluar se si inovacionet në Fintech, duke përfshirë përdorimin e Inteligjencës Artificiale, po ndryshojnë peizazhin e sigurisë financiare dhe çfarë rreziqesh sjell për bizneset dhe shoqërinë civile. Lufta kundër pastrimit të parave, financimi i terrorizmit dhe financimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë mbetet kriter kyç në kuadër të progresit të negociatave për anëtarësim në BE për Kapitullin 24. Pjesëmarrësit, gjithashtu do të njihen me praktikën më të mira europiane për parandalimin e mashtrimeve dhe mënyrat për të informuar dhe ndërgjegjësuar efektivisht grupet e interesit. Aktiviteti lidhet ngushtë me **Strategjinë e Agjencisë së Inteligjencës Financiare për Edukimin e Publikut mbi Rrezikun që mbart Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit në Shoqëri 2025-2027**, duke i dhënë mundësi pjesëmarrësve të diskutojnë dhe të japin rekomandime për mënyra më efektive të ndërgjegjësimit dhe edukimit të grupeve të ndryshme të interesit.

Për shkak të numrit të kufizuar të vendeve ju ftojmë të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj deri më **27 tetor**, në:
info@fint.gov.al

Presim me kënaqësi angazhimin dhe kontributin tuaj në këtë aktivitet!

**Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryezë Diskutimi: Informimi dhe Ndërgjegjësimi mbi Fintech – Risitë dhe Rreziqet në kuadër të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

30 tetor 2025, ora 09:30 – 11:30
Gold Orchid, Xheko Imperial Hotel, Tiranë

09:30 - 10:00 **Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe kafja e mirëseardhjes**

10:00 - 10:30 **Fjala Përshëndetëse**

Z. Ervin Koçi, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare

Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Znj. Valentina Semi, Zv. Drejtore e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, të Kontabilitetit dhe të Financës, Banka e Shqipërisë

Perspektivat e sektorit financiar përballë risive të FinTech

Znj. Ada Qazolli, Kryetare e Komitetit të Përputhshmërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave

Znj. Irida Goxharaj, Menaxhere e Zyrës Ekzekutive, Shoqata Shqiptare e Këmbimit Valutor

10:30 - 10:50 **FinTech dhe monitorimi financiar: Roli i Agjencisë së Inteligjencës Financiare**

- *Përdorimi i teknologjive FinTech në analizën e transaksioneve financiare dhe parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë*
- *Evolucioni i FinTech dhe implikimet për inteligjencën financiare - kuadri ligjor*
- *Hapat e ndërmarra për t'u përshtatur me risitë teknologjike dhe standardet europiane*

Znj. Redina Nasi, Përgjegjëse e Sektorit FINTECH, Drejtorja e Analizës Financiare, Agjencia e Inteligjencës Financiare



Financuar nga
Bashkimi Evropian



10:50 - 11:15 **Risitë dhe Rreziqet e FinTech: Mashtrimet Financiarë, Inteligjenca Artificiale, dhe Përvojat Europiane**

- *Risitë dhe shërbimet e të Fintech dhe ndikimi i tyre në sektorin financiar.*
- *Rreziqet për grupet e ndryshme të interesit kur informacioni mungon, me fokus në pastrimin e parave dhe krimin e organizuar (OSHC, sektori privat, veçanërisht bankat).*
- *Përdorimi i Inteligjencës Artificiale dhe mjeteve deepfake në mashtrimet financiare (CEO fraud) dhe impakti i tyre në sigurinë financiare.*
- *Praktikat dhe përvojat e Sllovakisë dhe Bashkimit Evropian në ndërgjegjësim dhe edukim publik.*

Z. Andrej Leontiev, Avokat dhe ekspert për çështjet e pastrimit të parave,
Bashkëthemelues i zyrës së avokatisë Taylor Wessing në Bratislavë

11:15-11:30 **Diskutim ndërveprues me pjesëmarrësit**

11:30 – 12.00 **Mbyllja e aktivitetit dhe koktejl**